

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

PROJEKTRREGULLORE

PËR

LICENCIMIN E AGJENCISË SË VLERËSIMIT TË
RREZIKUT TË KREDITIT DHE NJOHJEN E NJË AGJENCIE
TË HUAJ TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË KREDITIT

Miratuar me Vendim Bordi Nr. [...], datë [...]

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

1. Përcaktimi i formës së kërkesës, procedurës dhe afateve për licencimin e Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit që kërkon të kryejë veprimtari të vlerësimit të rrezikut të kreditit, sipas përcaktimit të nenit 3 pika 21 të Ligjit, me qëllim sigurimin e integritetit, transparencës, besueshmërisë, mirë-qeverisjes dhe pavarësisë së duhur të veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, për të siguruar vlerësime të drejta dhe cilësore në funksion të mbrojtjes së investitorit;
2. Përcaktimi i kërkesave për njohjen nga Autoriteti të një Agjencie të Huaj të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit;
3. Përcaktimi i kërkesave për raportim të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 238, 239, pika 2 dhe nenit 240, pika 2 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.5.2020, 'Për Tregjet e Kapitalit', këtej e tutje referuar si 'Ligji'.

Neni 3

Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" të referuar në këtë rregullore si "Ligji".

Neni 4

Fusha e Zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit, të cilat bëhen publike apo i shpërndahen publikut me anë të abonimit.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - a) vlerësimet private të rrezikut të kreditit, të kryera në bazë të një urdhri individual, të cilat i ofrohen ekskluzivisht personit që ka dhënë urdhrin dhe nuk janë të destinuara për publikun apo nënshkruesit e titujve;
 - b) sistemet e vlerësimit të cilësisë së kreditit ose vlerësime të ngjashme në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënie investimi, tregtare ose industriale;
 - c) vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga agjencitë e kredive të eksportit;
 - ç) vlerësimet e rrezikut të kreditit të kryera nga banka qendrore:
 - i. të cilat nuk paguhen nga subjekti i vlerësuar;
 - ii. të cilat nuk i bëhen të ditura publikut;
 - iii. të cilat nxirren në përputhje me parimet, standardet dhe procedurat, që sigurojnë integritetin dhe pavarësinë e duhur të veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, dhe
 - iv. të cilat nuk kanë të bëjnë me instrumente financiare të emetuara nga shteti përkatës i bankës qendrore

Neni 5

Ndalimi i aktivitetit të palicencuar të Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

Asnjë person nuk mund të themelojë, të ushtrojë aktivitetin, të mbajë, apo të asistojë në themelimin, ushtrimin e aktivitetit ose mbajtjen, ose të pretendojë se ofron shërbime si agjenci e vlerësimit të rrezikut të kreditit, nëse:

- a) nuk është licencuar nga Autoriteti;
- b) nuk është njohur nga Autoriteti, nëse është agjenci e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Neni 6

Përdorimi i Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Shoqëritë komisionere, shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, sipërmarrjet e investimeve kolektive si dhe shoqëritë administruese të fondeve të pensionit mund të përdorin vlerësime të rrezikut të kreditit për qëllime të kërkesave rregullatore, vetëm nëse këto vlerësime janë dhënë nga agjenci të vlerësimit të kreditit të licencuara apo njohura nga Autoriteti.
2. Kur prospekti, i hartuar në përputhje me rregulloren në fuqi për prospektin që publikohet kur kur Titujt i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, përmban një referencë të lidhur me një apo disa vlerësime të rrezikut të kreditit, emetuesi, ofruesi apo personi që kërkon pranimin për tregtim të titujve në një treg të rregulluar duhet të sigurojë që prospekti përfshin një informacion të qartë dhe të dukshëm që sqaron nëse vlerësimet e rrezikut të kreditit të përmendura në prospekt janë dhënë osë jo nga agjenci të vlerësimit të kreditit të licencuara apo njohura në zbatim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.

KREU II

KËRKESA PËR LICENCIM

Neni 7

Të përgjithshme

1. Autoriteti miraton kërkesën për licencë si agjenci e vlerësimit të rrezikut të kreditit vetëm kur konsideron se operatori i agjencisë është i aftë dhe i përshtatshëm dhe se sistemet e tij janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Operatori i agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit i jep Autoritetit të gjithë informacionin që mund të kërkohet nga ky i fundit për veprimtaritë e propozuara, përfshirë ato tregtare dhe strukturën organizative të nevojshme, në mënyrë që Autoriteti të mund të vlerësojë nëse operatori i agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ka marrë, në momentin e licencimit, të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas dispozitave të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
3. Çdo kërkesë për licencë si operator i një agjencie të vlerësimit të rrezikut të kreditit, e cila bëhet në zbatim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, duhet të shoqërohet me:

- a) informacion për çdo masë që operatori zbaton ose propozon të zbatojë për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të tij; dhe
 - b) informacion për masat organizative.
4. Operatori i agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, të cilit i është dhënë licencë në zbatim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga Autoriteti dhe duhet të sigurojë që është në çdo moment në përputhshmëri me këtë ligj dhe me çdo akt nënligjor të nxjerrë në zbatim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 8

Aplikimi për licencë për të themeluar dhe operuar një agjenci vendase të vlerësimit të rrezikut të kreditit

1. Çdo person juridik që kërkon të licencohet për të ushtruar veprimtari në Republikën e Shqipërisë si agjenci e vlerësimit të rrezikut të kreditit mund të paraqesë me shkrim kërkesën për licencim pranë Autoritetit.
2. Kërkesa e paraqitur në paragrafin 1 të këtij neni shoqërohet me informacionin e renditur në shtojcën II të kësaj rregulloreje.
3. Çdo informacion, që i paraqitet Autoritetit gjatë procesit të licencimit së agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, shoqërohet me një shkresë të nënshkruar nga një prej drejtuesve të lartë të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ose një përfaqësues i autorizuar nga drejtuesit e lartë, e cila vërteton se informacioni i paraqitur është i saktë dhe i plotë për atë që kanë ata dijeni në datën e paraqitjes së kërkesës.
4. Dokumentacioni i kërkuar sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e noterizuar.
5. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga një autoritet i huaj rregullator, dokumentacioni duhet të legalizohet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:
 - a. Konfirmim nga autoriteti i huaj rregullator siç përcaktohet në legjislacionin e atij vendi;
 - b. Përputhje me përcaktimet në aktet ligjore përkatëse të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
6. Dokumentacioni që merret me kërkesë të personit, duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 (tre) muaj nga dorëzimi i kërkesës për licencim apo njohje.
7. Subjekti kërkues i licencës është përgjegjës për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar në Autoritet.

Neni 9

Struktura Aksionare

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dorëzon Autoritetit listën e personave që zotërojnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi 10 % ose më shumë të kapitalit të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ose të të drejtave të votës, sipas pikës 1 dhe 2 të Shtojcës III të kësaj rregulloreje.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit listën e shoqërive në të cilën personi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni zotëron 10 % ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës sipas pikës 3 të Shtojcës III të kësaj rregulloreje.
3. Kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është një shoqëri e kontrolluar, ajo jep informacion për:
 - a) vendin ku është themeluar shoqëria mëmë;
 - b) nëse shoqëria mëmë është e autorizuar ose e regjistruar dhe nëse është subjekt i mbikëqyrjes të ndonjë autoriteti rregullator.

Neni 10

Dokumentacioni mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit

Dokumentacioni mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit përmban si më poshtë:

1. Strukturën aksionare të kapitalit të shoqërisë.
2. Për aksionarët me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë kërkuese, një përmbledhje e veprimtarisë/aktivitetit të tyre.
3. Të dhëna për shoqëri të tjera, ku aksionari me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë komisionere, është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll.
4. Strukturën dhe listën e aksionarëve përfitues fundorë të shoqërisë kërkuese.
5. Të dhëna për integritetin dhe burimin e kapitalit.

I. Kur aksionari është person juridik, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:

- a) Ekstraktin e regjistrimit në QKB;
- b) Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;
- c) Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;
- ç) Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

d) Deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale;

dh) Dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

II. Kur aksionari është individ, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:

a) Dokument identifikimi (ID/ pasaporte);

b) Curriculum vitae;

c) Diploma, kualifikime, trajnime;

ç) Dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

d) Dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

dh) Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

e) Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente si më poshtë:

i. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

ii. Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;

iii. Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;

iv. Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;

v. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

6. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 5 të këtij neni plotësohet edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik me pjesëmarrje influencuese, që zotërojnë mbi 30% të aksioneve me të drejtë vote. Kjo kërkesë duhet të plotësohet nga subjekti kërkuar gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës.

Neni 11

Struktura e pronësisë për shoqëri të kontrolluara

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një strukturë që tregon lidhjet e pronësisë midis shoqërive mëmë, shoqërive të kontrolluara dhe çdo subjekti të lidhur me to në

vendet e treta, përfshirë degët e tyre. Në strukturën e pronësisë çdo shoqëri paraqitet me emrin e saj të plotë, statusin juridik, adresën e selisë së regjistruar dhe selisë qendrore.

Neni 12

Kërkesat organizative për operatorin e Agjencisë vendase të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Personi, i cili administron efektivisht aktivitetin tregtar dhe veprimtarinë e Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, duhet të përmbushë kërkesat e aftësisë dhe përshtatshmërisë sipas nenit 13 të Ligjit dhe të ketë reputacion të mirë e përvojë të mjaftueshme për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të agjencisë.
2. Operatori i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit i njofton Autoritetit identitetin dhe çdo ndryshim të mëpasshëm të personit që në mënyrë efektive drejton aktivitetin tregtar dhe veprimtarinë e Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit përpara se të zbatohen këto ndryshime.
3. Autoriteti nuk miraton ndryshimet e propozuara kur gjykon se ka arsye për të besuar se personi ose personat e propozuar për të drejtuar aktivitetin tregtar të Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit rrezikon ose rrezikojnë në mënyrë thelbësore administrimin dhe veprimtarinë e shëndoshë e të kujdesshme të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Neni 13

Dokumentacioni mbi rregullat, procedurat dhe sistemet e subjektit kërkues

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit që kërkon të licencohet depoziton në Autoritet dokumentacion mbi rregullat, procedurat dhe sistemet që përfshijnë sa më poshtë:
 - a) Dokument ku parashikohet një përshkrim mbi sistemin e teknologjisë së informacionit, të kontabilitetit dhe të kontrollit, në pronësi apo në përdorim, për të dëshmuar se kanë dhe përdorin në mënyrë efikase burimet e procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë në mënyrën e duhur;
 - b) planin e biznesit, minimumi për tre vitet e para të aktivitetit, përfshirë përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë;
 - c) një përshkrim mbi strukturën përgjegjëse për miratimin dhe ndryshimin e rregulloreve dhe procedurave;
 - ç) një përshkrim mbi mënyrën se si do të sigurohet dhe monitorohet zbatimi i rregulloreve dhe procedurave, dhe njësia përgjegjëse për zbatueshmërinë e tyre;
 - d) një përshkrim të masave që do merren në rastin e shkeljes së rregullave;

- dh) një përshkrim të procedurës së raportimit në Autoritet në rast të moszbatimit të rregulloreve ose procedurave, që mund të rezultojë në shkelje të kushteve të licencimit dhe njohjes së veprimtarisë së agjencisë së huaj;
- e) rregulla për të identifikuar qartë dhe për të administruar pasojat e mundshme negative, që mund të shkaktohen në aktivitetin e përditshëm tregtar apo klientëve, si pasojë e konfliktit të interesit midis interesit të aksionarëve apo ortakëve të operatorit, ose operatorit dhe funksionimit të shëndoshë të veprimtarisë tregtare;
- ë) rregulla për administrimin e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet, për të zbatuar masat dhe sistemet e duhura për identifikimin e të gjitha rreziqeve të rëndësishme ndaj veprimtarisë së tij dhe masat efektive për zbutjen e këtyre rreziqeve;
- f) rregulla apo procedura për administrimin e shëndoshë të operacioneve teknike të sistemeve, përfshirë edhe nënkontraktimin tek të tretë dhe miratimin e masave efektive për t'i bërë ballë rrezikut të ndërprerjes së funksionimit të sistemeve;
- g) masa apo mekanizma për të siguruar verifikimin e mjaftueshmërisë dhe cilësisë së informacionit mbi të cilin agjencia bazon vlerësimet e saj;
- gj) procedura lidhur me modelet, metodikat dhe supozimet kyçe mbi të cilat bazohen vlerësimet;
- h) masat për publikimin e një raporti vjetor të transparencës;
- i) masat për krijimin e një funksioni të brendshëm për të kontrolluar cilësinë e vlerësimeve të dhëna nga agjencia;
- j) masat për të siguruar, në momentin e licencimit dhe në vijimësi, burime të mjaftueshme financiare për të mundësuar funksionimin e rregullt të saj, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e veprimtarisë tregtare, si dhe natyrën dhe shkallën e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet;
- k) informacion për sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe informacion për procedurat operacionale.

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet autoritetit informacion rreth rregulloreve dhe procedurave për funksionin e përputhshmërisë, parashikuar në pikën 5 të Pjesës A të Shtojcës XIII, funksionin e rishikimit të metodave, sipas parashikimit në pikën 9 të Pjesës A të Shtojcës XIII dhe informacione lidhur me rregulloret dhe procedurat e hartuara për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 4 dhe 10 të Pjesës A të Shtojcës XIII. Informacioni i parashikuar në këtë paragraf përfshin informacionin që përcaktohet në Shtojcën IV, pikat 1, 3 dhe 4.

3. Në rast se rregulloret dhe procedurat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni zbatohen në nivel grupi të shoqërive, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dërgon Autoritetit edhe informacionin e parashikuar në Shtojcën IV, pika 2.

4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacionin e parashikuar në Shtojcën X, të kësaj rregullore.

Neni 14

Struktura Organizative

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit depoziton në Autoritet organigramën ku paraqitet në detaje strukturën e saj organizative, përfshi identifikimin e qartë të funksioneve të rëndësishme dhe identitetit të personit përgjegjës për çdo funksion.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacion lidhur me drejtuesit e lartë të shoqërisë dhe personat përgjegjës për administrimin, anëtarët e pavarur dhe komitetet e ngritura, si dhe rregulloret e procedurat e brendshme të strukturës organizative.
3. Në rast se agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit vepron në përputhje me një kod të njohur të sjelljes së qeverisjes korporative, ajo identifikon kodin dhe paraqet shpjegime për çdo rast devijimi prej tij.
4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet informacionin e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të Shtojcës V për anëtarët e këshillit të saj të administrimit ose këshillit mbikëqyrës.
5. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dorëzon Autoritetit një kopje të dokumenteve të përmendura në pikën 3 të Shtojcës V.
6. Funksionet e rëndësishme/funksionarë kryesorë përfshijnë të paktën, administratorin dhe drejtuesit e nivelit të lartë, personat që drejtojnë veprimtaritë e degëve dhe analistët e lartë vlerësues.
7. Në rast se agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit kryen shërbime ndihmëse, organigrama paraqet me detaje edhe strukturën organizative në raport me këto shërbime.

Neni 15

Dokumentacioni për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe drejtuesit e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit

Dokumentacioni mbi administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin kryesor është si më poshtë:

1. Dokument identifikimi (ID/ pasaportë).
2. Curriculum Vitae, ku të detajohet përvoja profesionale.
3. Diploma, kualifikime, trajnime dhe dokumente të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale.
4. Dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore.
5. Vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.
6. Dokumentacion të lëshuar nga organet kompetente, si më poshtë:

- a) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- b) Vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;
- c) Vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;
- ç) Dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.

7. Deklaratë personale se:

- a) Nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
- b) Nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;
- c) Nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

8. Deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Neni 16 **Raportet financiare**

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dorëzon Autoritetit një kopje të raporteve të saj financiare vjetore të audituara, përfshi pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara, për tri vitet e fundit ushtrimore përpara paraqitjes së kërkesës si dhe raportin e auditimit.
2. Në rast se raportet financiare të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni nuk janë disponueshme brenda afatit të kërkuar, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dorëzon Autoritetit një raport të ndërmjetëm financiar.
3. Në rast se agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është shoqëri e kontrolluar, ajo paraqet raportet financiare vjetore të shoqërisë mëmë për tri vitet e fundit ushtrimore përpara datës së paraqitjes së kërkesës.
4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një përshkrim të masave që ka marrë për të siguruar zbatimin e standardeve të kontabilitetit.

Neni 17 **Personeli dhe Shpërblimet**

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacion lidhur me:

- a) analistët kryesorë të vlerësimit të rrezikut të kreditit, analistëve të tjerë të vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe personave që miratojnë vlerësimin e rrezikut të kreditit;
 - b) praktikantët e shpërblimit dhe të vlerësimit të punës për analistët e vlerësimit të rrezikut të kreditit, personat që miratojnë vlerësimet e rrezikut të kreditit, drejtuesit e lartë dhe personin përgjegjës për përputhshmërinë;
 - c) trajnimin dhe zhvillimin profesional që lidhet me procesin e vlerësimit të rrezikut, ku përfshihet kryerja e një provimi apo lloje të tjera vlerësimi formal të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të vlerësimit të rrezikut.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet gjithashtu Autoritetit:
- a) për çdo klasë vlerësimi të rrezikut të kreditit, të dhëna mbi përvojën e ekipeve përgjegjëse për hartimin dhe rishikimin e metodikave dhe modeleve, si dhe numrin e personave të përfshirë;
 - b) emrin dhe funksionin e çdo punonjësi të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, i cili ka detyrime, individualisht ose për llogari të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, ndaj çdo subjekti tjetër brenda grupit të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit;
 - c) shpërblimin e analistëve vlerësues, analistëve kryesorë vlerësues dhe funksionarit të përputhshmërisë për secilin prej tri viteve ushtrimore paraardhëse.
3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet rregullat që zbaton për marrjen e informacionit kur një analist i vlerësimit të rrezikut ndërpret marrëdhëniet e tij/të saj të punës dhe punësohet në një subjekt të vlerësuar, sipas parashikimeve të pikës 6, Pjesa C, Shtojca XIII. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet rregullat e miratuara për t'u siguruar që personat e përmendur në pikën 1 të Pjesës C të Shtojcës XIII janë të vetëdijshëm për ndalimin e vendosur sipas parashikimeve të pikës 7, të Pjesës C, të Shtojcës XIII.

KREU III

KËRKESAT PËR NJOHJE

Neni 18

Formati i kërkesës

1. Çdo person juridik, i licencuar ose i njohur si agjenci e vlerësimit të rrezikut të kreditit në një vend të huaj mund të paraqesë me shkrim në gjuhën shqipe kërkesën për njohje si agjenci e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit pranë Autoritetit në përputhje me kërkesat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje.
2. Çdo informacion, që i paraqitet Autoritetit gjatë procesit të njohjes së agjencisë së huaj të vlerësimit të rrezikut të kreditit, shoqërohet me një shkresë të nënshkruar nga një prej drejtuesve të lartë të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ose një përfaqësues i autorizuar nga drejtuesit e lartë, e cila vërteton se informacioni i paraqitur është i saktë dhe i plotë për aq sa kanë ata dijeni në datën e paraqitjes së kërkesës.
3. Autoriteti njih automatikisht të gjitha agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit, të licencuara apo të njohura nga Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve (ESMA).
4. Agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit siguron që informacioni i paraqitur të identifikojë qartë se cilave kërkesa të kësaj rregulloreje u referohet dhe në cilin dokument gjendet informacioni.
5. Agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit që kërkon të njihet dorëzon informacionin sipas Shtojcës XIII të kësaj rregulloreje, ku identifikon dokumentin në të cilin paraqitet informacioni që kërkohet në përputhje me këtë rregullore.
6. Agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit deklaron duke dhënë arsyet në Shtojcën 1, nëse ndonjë prej kërkesave të kësaj rregulloreje nuk gjen zbatim për kërkesën e saj.
7. Autoriteti mund të njohë agjencinë e huaj të vlerësimit të kreditit kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) është licencuar sipas kërkesave të vendit të origjinës subjekt i mbikëqyrjes dhe monitorimit efikas në vendin e huaj dhe siguron përputhjen e plotë me kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme në atë vend;
 - b) konstaton se zbaton kërkesa ligjore dhe ka një kuadër mbikëqyrës ekuivalent me kërkesat e parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore;
 - c) gjatë vlerësimit të ekuivalencës sipas shkronjës b të paragrafit 7 të këtij neni Autoriteti merr parasysh nëse kuadri ligjor dhe mbikëqyrës i vendit të origjinës ku është licencuar agjencia e vlerësimit të kreditit është ekuivalent me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore si dhe në veçanti me kërkesat e përcaktuara në shtojcën XIII të kësaj rregulloreje si dhe që regjimi rregullator i vendit të origjinës të ketë marrë masa që parandalojnë që autoritetet publike apo mbikëqyrëse të atij vendi nuk

interferojnë/ndërhyjnë në përmbajtjen dhe metodologjinë e agjencisë së vlerësimit të kreditit.

- ç) vlerësimet e kreditit të lëshuara nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe veprimtaria e saj nuk janë me rëndësi sistemike për stabilitetin e sistemit financiar dhe integritetin e tregjeve financiare. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacionin e parashikuar në Shtojcën XII lidhur me rëndësinë sistemike të vlerësimeve të saj të rrezikut të kreditit dhe veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit në stabilitetin financiar ose integritetin e tregjeve financiare.
- d) autoriteti kompetent i vendit të origjinës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me Autoritetin në kuadër të marrëveshjes së IOSCO-s (Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve).
8. Gjatë vlerësimit nëse kushtet e referuara në paragrafin 7 të këtij neni janë plotësuar, Autoriteti konsultohet me autoritetin përgjegjës mbikëqyrës të vendeve të huaja.
9. Autoriteti gjykon se operatori i agjencisë së huaj të vlerësimit të rrezikut të kreditit përmbush kërkesat e pikës 4, të nenit 239 të Ligjit si më poshtë:
- a) investitorit u sigurohet mbrojtje e njëjtë me mbrojtjen që do të gëzonin nëse operatori në fjalë do të ishte i detyruar të përmbushte kërkesat e licencimit si agjenci e vlerësimit të rrezikut të kreditit në zbatim të kësaj pjese;
 - b) subjekti kërkues është i aftë dhe i gatshëm të bashkëpunojë me Autoritetin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe në mënyra të tjera; dhe
 - c) ekzistojnë masa adekuate për bashkëpunimin midis Autoritetit dhe personave përgjegjës për mbikëqyrjen e subjektit kërkues në vendin ose territorin në të cilin ndodhet selia qendrore e subjektit kërkues.
 - i. Marrëveshjet e parashikuara në shkronjën c të pikës 9 të këtij neni duhet të specifikojnë mekanizmin për shkëmbimin e informacionit;
 - ii. Procedurat lidhur me koordinimin e aktivitetit mbikëqyrës.

Neni 19

Dokumentacioni për njohjen e Agjencisë së Huaj të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit e cila kërkon të njihet nga Autoriteti depoziton dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për njohjen e licencës së dhënë nga autoriteti i huaj, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të rrezikut të kreditit, të firmosur nga përfaqësuesi ligjor i personit të huaj;
 - b) Kopje ose të dhëna të licencës, ku të specifikohet lloji i klasave, për të cilin është lëshuar licenca;
 - c) Vendimin e organit kompetent të shoqërisë në vendin e origjinës për të ushtruar veprimtarinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit, në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ç) Vendndodhjen e selisë qendrore;
 - d) Informacion mbi njoftimin e autoritetit rregullator të vendit të origjinës për kryerjen e veprimtarisë së kërkuar;
 - dh) Një përshkrim të shërbimeve të synuara që do të ofrohen nga agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit si dhe mënyrën se si ajo do të sigurojë përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë;
 - e) Deklaratë se anëtarët e organeve drejtuese, drejtuesit dhe personat që ushtrojnë kontroll mbi subjektin kërkues plotësojnë kriteret e aftësisë dhe të përshtatshmërisë;
 - ë) Dokument që të vërtetojë ekzistencën e rregullave ekuivalente në legjislacionin e vendit të origjinës të kërkuesit me legjislacionin e aplikuar në Republikën e Shqipërisë, apo një relacion shpjegues se si është përmbushur kërkesa për ekuivalencën dhe përputhjen me kërkesat e Ligjit dhe kësaj rregulloreje;
 - f) Vetëdeklarim i nënshkruar nga organi kompetent i subjektit kërkues ose përfaqësuesi i tij ligjor se subjekti në fjalë do të veprojë në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare, do të respektojë etikën profesionale e do t'u ofrojë investitorëve në Republikën e Shqipërisë trajtim të barabartë.
2. Gjatë procesit të njohjes së subjektit kërkues për kryerjen e veprimtarisë së agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit Autoriteti bashkëpunon dhe shkëmben informacion me autoritetin e huaj përkatës.
3. Dokument që vërteton shlyerjen e pagesave ndaj Autoritetit.
4. Procedura që dokumentojnë se vlerësimi kryhet mbi baza dhe analiza të arsyeshme dhe në përputhje me metodologjinë e përdorur.
5. Përpara kërkesës për njohje metodat e vlerësimit duhet të kenë qenë në përdorim për të paktën 3 vite dhe dhe të ketë evidenca për cilësinë e efektivitetit të këtyre metodave.

6. Evidencë se ka burime të mjaftueshme financiare, personel, dhe procedura për një vlerësim cilësor të rrezikut të kreditit.
7. Informacion dhe dokumentacion mbështetës që vërteton njohjen nga ndonjë Autoritet tjetër rregullator.
8. Kërkesa për njohje duhet të përmbajë informacion lidhur me klasën e vlerësimit të rrezikut të kreditit duke përdorur klasat e mëposhtme të vlerësimit të rrezikut:
 - a) vlerësimet e rrezikut sovran dhe të financimit publik;
 - b) vlerësimet e rrezikut të financimit të strukturuar;
 - c) vlerësimet e rrezikut korporativ:
 - (i) institucion financiar, përfshi bankat dhe shoqëritë komisionere;
 - (ii) shoqëri sigurimi;
 - (iii) emetues – shoqëri aksionare që nuk është institucion financiar

Neni 20
Shqyrtimi i dokumentacionit dhe Marrja e vendimit

1. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti mund të kërkojë çdo informacion të mëtejshëm që është i nevojshëm për të gjykuar mbi plotësimin e kritereve nga subjekti kërkuar.
2. Kërkesa për plotësim dokumentacioni dhe/ose përmirësim i përmbajtjes së dokumenteve të depozituara, i komunikohet subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike.
3. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti vlerëson:
 - a) përmbushjen e kritereve për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve, administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës, si dhe drejtuesve kryesorë sipas kërkesave të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
 - b) përputhshmërinë e subjektit kërkuar me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
 - c) aftësinë e subjektit kërkuar për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e licencimit/njohjes.
4. Autoriteti merr vendim për licencim/njohje apo miratim të ndryshimeve brenda 3 (tre) muajve nga plotësimi i kërkesave të Ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 21
Refuzimi i licencës/njohjes

Autoriteti refuzon licencën/njohjen për agjencinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit:

- a) nëse subjekti kërkuar nuk përmbush ndonjë prej kërkesave për licencim dhe në veçanti nëse, duke mbajtur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, Autoriteti nuk bindet për përshtatshmërinë e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, organit drejtues dhe funksionarëve kryesorë;
- b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje; dhe
- c) kur ushtrimi efektiv i funksioneve të tij mbikëqyrëse pengohet nga:
 - i. lidhjet e ngushta midis agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe personave të tjerë juridikë ose fizikë;
 - ii. aktet ligjore, nënligjore ose administrative të një vendi ose territori tjetër që rregullojnë aktivitetin e personave fizikë/individëve ose juridikë me të cilët ka lidhje të ngushta agjencia e vlerësimit të kreditit;

- iii. vështirësitë e lidhura me zbatimin e detyrueshëm të këtyre akteve ligjore, nënligjore dhe administrative.

Neni 22

Heqja e licencës ose njohjes së Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Nëse në vlerësimin e Autoritetit, agjencia e licencuar ose e njohur e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka shkelur ndonjë dispozitë të këtij Ligji ose të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose për zbatimin e pretenduar të dispozitave ligjore i ka dhënë Autoritetit informacione të rreme, të pasakta ose keqinformuese, ose ka shkelur ndonjë ndalim ose kërkesë të vendosur në zbatim të këtij ligji, Autoriteti mund të urdhërojë me shkrim:

a) heqjen e licencimit ose njohjes së personit në fjalë;

ose

b) pezullimin e licencës ose njohjes së personit në fjalë për një periudhë të përcaktuar, ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të caktuar, ose deri në përmbushjen e kushteve të caktuara.

2. Pezullimi sipas këtij neni nuk mund të bëhet për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Megjithatë, nëse e konsideron të nevojshme, Autoriteti mund të zgjasë afatin e pezullimit për një periudhë tjetër jo më të gjatë se tre muaj.

3. Në përfundim të periudhës së pezullimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Autoriteti duhet të heqë masën e pezullimit ose të heqë licencën, ose njohjen, siç e gjykon të përshtatshme Autoriteti.

4. Autoriteti mund të heqë ose të pezullojë licencën ose njohjen pa i dhënë personit në fjalë mundësi të shprehet kur:

a) personi bëhet subjekt i një procedure likuidimi ose falimentimi;

b) personi kryen veprimtari të rregulluara jashtë objektit të licencës;

c) është emëruar një administrator falimentimi ose një administrator tjetër i ngjashëm për një pjesë të konsiderueshme të pasurisë së personit të licencuar ose të njohur;

ç) personi pushon së ushtruar veprimtarinë e rregulluar për një periudhë prej më shumë se 30 ditësh, me përjashtim të rastit kur ka marrë miratimin paraprak nga Autoriteti;

d) anëtarët e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës ose punonjësit kyç të personit në fjalë, në vlerësimin e Autoritetit, nuk kanë kryer detyrat e tyre në mënyrë të ndershme dhe të drejtë;

dh) personi ka shkelur ose nuk ka përmbushur një kusht të zbatueshëm në lidhje me licencën ose njohjen;

e) personi nuk ka zbatuar një urdhër të Autoritetit;

ë) personi nuk i jep Autoritetit informacionet e kërkuara nga ky i fundit;

f) personi jep informacion të rremë ose keqinformues;

g) personi nuk është më i aftë dhe i përshtatshëm për të ushtruar aktivitetin e licencuar ose njohur; ose

gj) personi shkel ndonjë dispozitë tjetër të nxjerrë në zbatim të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

5. Në rastin e një personi të huaj të njohur, Autoriteti mund të konsultohet me autoritetin e huaj rregullator përkatës përpara dhënies së urdhrit në zbatim të këtij neni, me përjashtim të rastit kur e çmon thelbësore në interes të investitorëve që urdhri të jepet menjëherë.

6. Autoriteti bën njoftim publik për çdo vendim të marrë sipas këtyre parashikimeve.

KREU IV LËSHIMI DHE RISHIKIMI I VLERËSIMEVE TË RREZIKUT TË KREDITIT

Neni 23

Hartimi, miratimi, rishikimi dhe paraqitja e metodës së vlerësimit të rrezikut të kreditit

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një përshkrim të përgjithshëm të modeleve dhe metodikave të përdorura për të përcaktuar vlerësimet e rrezikut të kreditit për çdo klasë.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacionin vijues mbi rregulloret dhe procedurat e saj:
 - a) informacion lidhur me hartimin, miratimin dhe rishikimin e metodave të saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshirë të paktën informacionin e parashikuar në pikën 1 të Shtojcës VII;
 - b) informacion lidhur me përcaktimin e metodave të vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe përshkrime të modeleve dhe supozimeve kyçe të vlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të Pikës I, të Pjesës E, të Shtojcës XIII.

Neni 24

Lëshimi i vlerësimit të rrezikut të kreditit

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacionin e mëposhtëm:
 - a) simbolet e vlerësimit të rrezikut për secilën klasë të vlerësimit të rrezikut të kreditit;
 - b) përcaktimin e çdo veprimi dhe statusi të vlerësimit të përdorur nga agjencia e vlerësimit të kreditit;
 - c) rregulloret dhe procedurat e saj mbi lëshimin e vlerësimeve të rrezikut të kreditit, përfshi të paktën informacionin e parashikuar në pikën 2 të Shtojcës VII;
 - ç) përshkrimin e rregullave të miratuara për njoftimin e vendimit të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi të paktën informacionin e parashikuar në pikën 3 të Shtojcës VII;
 - d) një përshkrim të procedurave në fuqi për të siguruar përdorimin dhe zbatimin e një metodike në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha klasat e vlerësimit të rrezikut të kreditit, zyrat dhe rajonet.

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit identifikon ndryshimet midis trajtimit të vlerësimeve të rrezikut të kreditit të kërkuara apo të pakërkuara nga entiteti i vlerësuar në rregulloret dhe procedurat e parashikuara në pikat (c) dhe (d) të paragrafit (1) të këtij neni.
3. Kur procesi i vlerësimit të rrezikut të kreditit auditohet rregullisht nga një palë e tretë, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit raportin e fundit të auditimit.
4. Gjithashtu, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacionet e mëposhtme:
 - a) detajet dhe kriteret për përzgjedhjen e ofruesve të të dhënave;
 - b) detajet mbi mbështetjen tek të dhënat e jashtme e të brendshme që përfshihen në modelet e vlerësimit;
 - c) detaje rreth burimeve të të dhënave që përdoren.

Neni 25

Monitorimi i vlerësimeve të rrezikut të kreditit

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit informacion lidhur me rregulloret dhe procedurat e saj që kanë të bëjnë me:

- (a) monitorimin e vlerësimeve të rrezikut, identifikimin e ndryshimeve midis vlerësimeve të kërkuara dhe të pakërkuara dhe përfshirjen të paktën të të dhënave të parashikuara në pikën 4 të Shtojcës VII;
- (b) paraqitjen e vendimit për rishikimin apo ndryshimin e vlerësimit të rrezikut;
- (c) monitorimin e ndikimit të ndryshimeve të kushteve makroekonomike ose të tregut financiar në vlerësimet e rrezikut të kreditit.

Neni 26

Pavarësia dhe shmangia e konflikteve të interesit

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit merr masa për të siguruar që lëshimi i vlerësimit të rrezikut të kreditit nuk ndikohet nga ndonjë konflikt ekzistues apo potencial i interesit, që përfshin vetë agjencinë, drejtuesit e saj, analistët që kryejnë vlerësimin, apo ndonjë person tjetër që kontrollon apo veprimtaria e të cilit kontrollohet nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit.
2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit duhet të veprojë në përputhje me kërkesat e shtojcës VIII dhe XIII të kësaj rregulloreje.
3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit duhet të sigurojë që personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të mos lejohen të iniciojnë apo marrin pjesë në negociata lidhur me tarifa apo pagesa me entitetet e vlerësuar, palë të lidhura apo ndonjë person tjetër që përmes kontrollit është i lidhur me entitetin e vlerësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë.

4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit merr masa për sigurimin e pavarësisë së analistëve që kryejnë vlerësimin e rrezikut të kreditit.

Neni 27

Regjistri i rasteve të konfliktit të interesit

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit regjistrin e përditësuar të rasteve të konfliktit të interesit të identifikuar dhe të mundshme. Kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është pjesë e një grupi, ajo përfshin në regjister çdo konflikt interesi që lind nga subjektet e tjera që i përkasin këtij grupi.
2. Regjistri i rasteve të konfliktit të interesit ekzistuese dhe të mundshme identifikon informacionin në vijim:
 - a) çdo konflikt të mundshëm interesi me palët e treta të lidhura;
 - b) çdo konflikt të mundshëm që lind nga kryerja e shërbimeve ndihmëse dhe aktiviteteve të deleguara të vlerësimit të rrezikut;
3. Regjistri i përmendur në pikën 1 të këtij neni shpjegon si do të eliminohet, administrohet dhe deklarohet konflikti i interesit.

Neni 28

Konflikti i interesit lidhur me shërbimet ndihmëse

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një përshkrim të burimeve njerëzore dhe teknike lidhur me shërbimin e vlerësimit të rrezikut dhe shërbimeve ndihmëse. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit përshkruan rregullat për parandalimin, deklarimin dhe zbutjen e çdo konflikti interesi ekzistues ose të mundshëm midis aktivitetit të vlerësimit të rrezikut dhe shërbimeve ndihmëse.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një kopje të rezultateve të vlerësimeve të brendshme të kryera për të identifikuar çdo konflikt interesi ekzistues ose të mundshëm midis aktivitetit të vlerësimit të rrezikut dhe shërbimeve ndihmëse.

Neni 29

Kërkesat për delegim

1. Kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit delegon funksione të rëndësishme të veprimtarisë së saj, ajo i paraqet Autoritetit informacionin në vijim:
 - a) rregullat e saj lidhur me delegimin;
 - b) shpjegim për mënyrën si synon të identifikojë, të administrojë dhe monitorojë rreziqet që paraqet delegimi i funksioneve të rëndësishme;
 - c) një kopje të marrëveshjeve të delegimit midis agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe subjektit të cilit i janë deleguar veprimtaritë;

- ç) raporte të brendshme ose të jashtme mbi veprimtarinë e deleguara gjatë pesë viteve të kaluara.
2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, funksionet e rëndësishme operative përfshijnë rishikimin e vlerësimit të rrezikut, analistin kryesor, hartimin dhe rishikimin e metodikës së vlerësimit të rrezikut të kreditit, kontrollin e brendshëm të cilësisë, ruajtjen e të dhënave, sistemet informatike, mbështetjen informatike dhe kontabilitetin.

KREU V

KËRKESAT PËR RAPORTIM DHE PUBLIKIM

Neni 30

Kërkesat e raportimit për Agjencinë e njohur të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

Të paktën një herë në vit, çdo agjenci e huaj e njohur e vlerësimit të rrezikut të kreditit përgatit një raport për Autoritetin, që përfshin edhe një deklaratë nëse kanë ndodhur ngjarje, të cilat mund:

- a) të ndikojnë në vlerësimin e Autoritetit nëse plotësohen kërkesat për njohjen; ose
- b) të kenë ndikim në konkurrencën në treg.

Neni 31

Raporti i Transparencës

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit publikon çdo vit një raport transparence që përfshin informacionin lidhur me çështjet e renditura në pjesën E të shtojcës XIII.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit publikon në faqen zyrtare raportin e transparencës jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit financiar dhe siguron që ky raport të mbetet i publikuar për të paktën pesë vite.

Neni 32

Publikimi i metodologjisë, modeleve dhe supozimeve

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit bën publike metodologjinë, modelet dhe supozimet që përdor për vlerësimin e rrezikut të kreditit.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit merr masa për të siguruar që vlerësimi që ajo nxjerr të jetë bërë mbi bazën e një analizë të gjerë mbi baza të arsyeshme dhe duke përdorur të gjithë informacionin në dispozicion.

Neni 33

Prezantimi i Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit siguron që vlerësimet e rrezikut të kreditit prezantohen dhe kryhen në përputhje me kërkesat e pjesës D të shtojcës XIII të kësaj rregulloreje.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit bën publike çdo vlerësim rreziku krediti si dhe çdo vendim për të anuluar vlerësimin e rrezikut të kreditit, shoqëruar me argumentet e plota për këtë vendim.
3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për rastin e vlerësimeve që jepen përmes abonimit.
4. Kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit nxjerr vlerësime për instrumentet financiare të strukturuar, sigurohet të dallohen qartë kategoritë e vlerësimit që u caktohen instrumenteve financiare të strukturuar, duke përdorur simbole shtesë që i dallojnë nga kategoritë e vlerësimit që përdoren për subjekte, apo instrumente financiare të tjera.
5. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit bën publike politikat dhe procedurat për vlerësime që nuk kryhen me iniciativë të entitetit të vlerësuar.

KREU VI PËRGJEGJËSIA NË KRYERJEN E VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË KREDITIT

Neni 34 Përgjegjësia

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të kreditit në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me aktet ligjore.
2. Emetuesi ose investitori është përgjegjës për paraqitjen e informacioneve të sakta dhe të detajuara, në rast se agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka kryer shkelje të kësaj Rregulloreje dhe se kjo shkelje ka ndikuar në vlerësimin e nxjerrë të rrezikut të kreditit.

Neni 35 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA I

REFERENCAT E DOKUMENTACIONIT

Kërkesat sipas neneve ose shtojcave të kësaj Rregulloreje	Titulli i dokumentit	Kreu ose pjesa ose faqja e dokumentit ku jepet informacioni ose arsyeja pse ky informacion nuk jepet
...		
...		
...		
...		

SHTOJCA II
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Emri i plotë i Agjencisë së Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit
2. Vendi i themelimit
3. Adresa e selisë së regjistruar
4. Statusi juridik
5. Lidhur me personin/personat e kontaktit për qëllime të paraqitjes së kërkesës:
 - (a) emri;
 - (b) titulli;
 - (c) adresa;
 - (d) adresa e postës elektronike;
 - (e) numri i telefonit.
6. Lidhur me personin përgjegjës të përputhshmërisë:
 - (a) emri;
 - (b) titulli;
 - (c) adresa;
 - (d) adresa e postës elektronike;
 - (e) numri i telefonit.
7. Identifikimi i klasës së vlerësimit të rrezikut të kreditit (lloji i institucionit/shoqërisë dhe instrumentit financiar), për të cilën shoqëria paraqet kërkesën për licencë?
8. Struktura e pronësisë
9. Struktura organizative dhe qeverisja korporatave
10. Burimet Financiare për kryerjen e veprimtarisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit
11. Informacion për punonjësit dhe përvojën profesionale të tyre
12. Informacion për analistët që do të kryejnë vlerësimet
13. Përshkrim të procedurave dhe metodologjive për nxjerrjen dhe rishikimin e vlerësimeve të rrezikut të kreditit
14. Politika dhe procedura për identifikimin, menaxhimin dhe zbulimin e konflikteve të interesit
15. Mekanizmat për kompensimin dhe vlerësimin e performancës

16. Përshkrimi i veprimtarisë tregtare që zhvillon agjencia e huaj e vlerësimit të rrezikut të kreditit, degët si dhe shërbime të tjera përveç atyre lidhur me vlerësimin e rrezikut të kreditit, që shoqëria kërkon të kryejë
17. Nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka degë, për secilën prej degëve:
- (a) emrin e plotë;
 - (b) statusin juridik;
 - (c) adresën dhe
 - (d) numrin e punonjësve të përkohshëm dhe punonjësve të përhershëm.
18. Identifikimi i tregjeve të rregulluara ku listohet agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit, nëse ka.
19. Raportet financiare:
- (a) që përshkruajnë nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është subjekt i audituar;
 - (b) nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit është e audituar, emrin e audituesit të jashtëm dhe numrin kombëtar të regjistrimit të audituesit të jashtëm;
 - (c) datën e fundit të vitit ushtrimor.
20. Dokumentacion dhe informacion i detajuar lidhur me procedurat për delegimin e veprimtarisë.

SHTOJCA III

INFORMACIONI QË DUHET PARAQITUR LIDHUR ME STRUKTURËN E PRONËSISË

1. Identifikimi i pronarëve/aksionarëve të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, në nivel të detajuar si më poshtë:

Pronari/aksionari	Përqindja e kapitalit	Natyra e pjesëmarrjes: e drejtpërdrejtë ose e tërthortë	Përqindja e të drejtave të votimit
...	...		
...	...		
...	...		

2. Përshkrimi i veprimtarive tregtare të pronarëve të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit

Pronari	Veprimtaritë tregtare
...	...
...	...
...	...

3. Identifikimi i veprimtarive tregtare të shoqërive ku pronarët kanë zotërimë

Pronari/Aksionari	Shoqëritë tregtare ku ka zotërimë pronari	Veprimtaritë tregtare
--------------------------	--	------------------------------

...	...	
...	...	
...	...	

SHTOJCA IV

STRUKTURA ORGANIZATIVE

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ofron informacionin në vijim lidhur me rregulloret dhe procedurat si kërkesë e kësaj Rregulloreje:
 - (a) Një përshkrim të roleve dhe përgjegjësive të punonjësve;
 - (b) një përshkrim të mekanizmave për monitorimin e efektivitetit të rregullores ose procedurës;
 - (c) numrin e punonjësve dhe raportin midis punonjësve të përkohshëm dhe të përhershëm;
 - (d) të dhëna mbi linjat e raportimit dhe frekuencën e raportimit dhe
 - (e) një përshkrim të ndërveprimit midis funksionit përkatës dhe punonjësit të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e vlerësimit dhe midis këtij funksioni dhe funksioneve të tjera.
2. Kur rregullat e parashikuara në pikën 1 të Shtojcës IV zbatohen në nivelin e grupit të shoqërive, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit një kopje të marrëveshjeve përkatëse në nivel shërbimesh që ka lidhur apo propozon të lidhë me anëtarë të tjerë të grupit, si dhe informacionin e mëposhtëm:
 - (a) një përshkrim të detyrave përkatëse të kryera nga secila prej shoqërive të grupit, përfshi shoqëritë me vendodhje në vendet e treta;
 - (b) një identifikim të qartë të shoqërisë së përfshirë në kryerjen e detyrës, duke përcaktuar vendndodhjen e saj;
 - (c) të dhëna mbi linjat dhe frekuencën e raportimit të çdo subjekti të përfshirë dhe mbi mënyrën sesi mblidhen të dhënat nga secili subjekt dhe
 - (d) informacion mbi çdo burim të dedikuar që gjendet në Bashkimin Evropian. Në rastin e burimeve njerëzore, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit specifikon kohën që i kushtohet funksionit mbështetur në njësi të barasvlershme me kohën e plotë.
3. Lidhur me funksionin e përputhshmërisë, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet informacionin e mëposhtëm:
 - (a) rregulloret dhe procedurat për raportimin e informacionit, sipas pikës 5 të Pjesës C të Shtojcës XIII të kësaj Rregulloreje;
 - (b) një përshkrim se si e siguron pavarësinë e funksionit të përputhshmërsë;
 - (c) raportin më të fundit të personit përgjegjës të përputhshmërisë;
 - (d) Planin e punës për tri vitet e ardhshme.
4. Lidhur me funksionin e auditimit të brendshëm, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet informacionin e mëposhtëm:
 - (a) një shpjegim se si hartohet dhe zbatohet metodika e saj e auditimit të brendshëm në përputhje me karakteristikat e posaçme të veprimtarive të saj dhe nivelin, kompleksitetin dhe rreziqet e tyre;
 - (b) planin e punës për tri vitet e ardhshme.

SHTOJCA V

INFORMACIONI QË PARAQITET LIDHUR ME QEVERISJEN KORPORATIVE

1. Identifikimi i anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës dhe komiteteve të ngritura :

Identiteti i anëtarëve	Organi (këshilli i administrimit, këshillit mbikëqyrës, komiteti i auditimit, komiteti i shpërblimeve, etj.,) dhe pozicioni	Organi i shoqërive të tjera ku personi është anëtar dhe pozicioni
...	...	
...	...	
...	...	

2. Identifikimi i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit ose të mbikëqyrjes, dhe vërtetimi i pavarësisë së tyre, si dhe njohuritë dhe përvoja në nivelet e larta të tregut të instrumenteve të strukturuar financiare, ku agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit bën kërkesë për nxjerrjen e vlerësimeve të rrezikut të kreditit të produkteve të strukturuar financiare:

Identiteti i anëtarit	Organi (këshilli i administrimit ose këshilli mbikëqyrës)	Anëtar i pavarur (PO/JO) dhe nëse PO, jepni arsyet	Përvojë në instrumentet financiare të strukturuar (PO/JO) dhe nëse PO, jepni arsyet
...	...		
...	...		
...	...		

3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i dorëzon Autoritetit një kopje të dokumenteve vijuese:

- (a) tre procesverbale të fundit të mbledhjeve të këshillit të administrimit dhe këshillit mbikëqyrës;
- (b) procesverbalin e fundit të mbledhjeve të komisioneve të tjera, si komisionet e shpërblimit apo të strategjisë dhe
- (c) tri opinionet ose raportet e fundit që i janë paraqitur këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës nga anëtarët e pavarur.

SHTOJCA VI
VETËDEKLARIMI

Çdo funksionar i lartë deklaron nëse përfshihet në njërin prej kategorive të mëposhtme:

- (a) është dënua për një veprë penale;
- (b) i është nënshtrua ose është njoftua për procedura me karakter disiplinor nga një organ rregullator ose me karakter penal;
- (c) ka qenë subjekt i gjetjeve të pafavorshme në çështje civile lidhur me ofrimin e shërbimeve financiare, sjelljen e papërshtatshme, mashtrimin ose menaxhimin e një personi juridik;
- (d) për aq sa është në dijeni, ai/ajo ka qenë subjekt i hetimeve ekzistuese ose të mëparshme nga ndonjë autoritet rregullator ose organ apo institucion shtetëror;
- (e) është përfshirë në një sipërmarrje, regjistrimi ose leja e së cilës është hequr nga një organ rregullator;
- (f) i është refuzuar e drejta të kryejë veprimtari që kërkojnë regjistrimin ose autorizimin nga organi rregullator;
- (g) është përfshirë në menaxhimin e një sipërmarrje, e cila ka arritur në situatë paaftësie paguese, likuidimi ose nën administrim, gjatë kohës që ky person ka pasur lidhje me sipërmarrjen ose brenda një viti nga shkëputja e tij prej sipërmarrjes;
- (h) është përfshirë në një sipërmarrje, e cila është hetuar ose pezulluar nga një organ rregullator dhe që ka sjellë si rezultat një masë ekzekutimi;
- (i) është hetuar, pezulluar ose sanksionuar nga një organ rregullator;
- (j) është përjashtuar nga mundësia për të vepruar si drejtor, është përjashtuar nga funksioni në çdo cilësi drejtuese, është shkarkuar nga puna ose nga çdo pozicion tjetër në shoqëri, për shkak të akuzave për sjellje të papërshtatshme në punë ose nga neglizhenca.

SHTOJCA VII

NXJERRJA DHE RISHIKIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË KREDITIT

1. Informacioni lidhur me rregulloret dhe procedurat e parashikuara mbi hartimin, miratimin dhe rishikimin e metodikave të vlerësimit të agjensisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit përfshin:
 - (a) përgjegjësitë dhe procesin e hartimit dhe nënshkrimit të metodikave të vlerësimit, përfshi detaje mbi përbërjen e komitetit të metodikës së vlerësimit dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve;
 - (b) përgjegjësitë dhe procesin për metodikën e vlerësimit, përfshi:
 - (i) verifikimin dhe miratimin e metodikës së vlerësimit;
 - (ii) miratimin e metodikës së vlerësimit bazuar në të dhënat historike, përfshi mënyrën se si pranohen rezultatet e testimit të të dhënave historike. Përveç kësaj, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit përfshin rezultatet e këtij miratimi/testimi mbi të dhënat historike për tri vitet paraardhëse, kur ka të dhëna sasiore të disponueshme;
 - (iii) raportimin e rezultatit të rishikimit të metodikës së vlerësimit dhe
 - (iv) zbatimin e ndryshimeve në metodikë, model ose supozimet kyçe të vlerësimit të rrezikut.
2. Informacioni lidhur me rregulloret dhe procedurat që kanë të bëjnë me lëshimin e vlerësimeve të rrezikut të kreditit përfshijnë:
 - (a) hapat e njëpasnjëshme të ndjekura për të dalë në vlerësimet e rrezikut; procesin e shqyrtimit të dokumentacionit të emetuesit ose titujve që do të vlerësohen. Këtu përfshihet çdo tregues reference i përdorur për të lehtësuar shqyrtimin;
 - (b) një vlerësim të kriterëve minimale të informacionit për të nisur dhe ruajtur një vlerësim të rrezikut të kreditit, përfshi informacionin publik dhe jopublik;
 - (c) mekanizmat e kontrollit për lëshimin e vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi angazhimin në proces të emetuesit/ndërmjetësit/investitorit/ofruesit të shërbimeve;
 - (d) procesin e shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të informacionit të përdorur për të përcaktuar vlerësimin e rrezikut të kreditit, përfshi, kur është e nevojshme, mbështetjen tek analiza e një agjencie tjetër të vlerësimit të rrezikut të kreditit ose palë të tjera të treta;
 - (e) rolin dhe përgjegjësitë e analistëve të vlerësimit të rrezikut, si dhe procesin dhe procedurat për zgjedhjen e tyre për tituj të caktuar;
 - (f) procesin e miratimit të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi identifikimin e rolit dhe përgjegjësiive të personave që miratojnë vlerësimet, si dhe procesin dhe procedurat për përzgjedhjen e tyre;
 - (g) kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka ngritur komitete të vlerësimit të kreditit, rolin dhe përgjegjësitë e kryetarëve të komiteteve të vlerësimit të rrezikut të kreditit, si dhe aftësitë që kërkohen e procesin dhe procedurat për emërimin e tyre dhe
 - (h) kualifikimet minimale të personave të përfshirë në vendimin e vlerësimit të rrezikut.
3. Informacioni lidhur me bërjen publik të vendimit të vlerësimit të rrezikut përfshin sa vijon:

- (a) procesin e njoftimit të subjektit të vlerësuar mbi bazën kryesore në të cilën është mbështetur vlerësimi i rrezikut, të paktën 12 orë përpara publikimit të vlerësimit të rrezikut të kreditit;
 - (b) procesin e ankimit të vlerësimit të rrezikut, nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit e ka vënë në zbatim dhe
 - (c) proceset për përcaktimin se cili prej elementeve kryesore ku mbështetet vlerësimi i rrezikut të kreditit do të përfshihet në deklaratën për shtyp ose në raporte.
4. Informacioni mbi monitorimin e vlerësimeve të rrezikut përfshin:
- (a) procesin e monitorimit, përfshi rolin dhe përgjegjësitë e komiteteve të vlerësimit, kur ka, si dhe një përshkrim të proceseve të miratimit të vlerësimit të rrezikut;
 - (b) rolin dhe përgjegjësitë e analistëve vlerësues;
 - (c) procesin e shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të informacionit të përdorur për monitorimin e një vlerësimi, përfshi, sipas rastit, mbështetjen tek analiza nga një agjenci tjetër e vlerësimit të rrezikut të kreditit ose palë të tjera të treta;
 - (d) procesin, përfshinjë panoramë të faktorëve të marrë në konsideratë, dhe përgjegjësitë për të vendosur se kur duhet rishikuar zyrtarisht vlerësimi, përfshi veprimet e vlerësimit të rrezikut;
 - (e) procesin dhe përgjegjësitë për të vendosur se kur duhet pezulluar ose tërhequr zyrtarisht vlerësimi i rrezikut;
 - (f) proceset dhe kontrollet që lidhen me rishikimet e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe
 - (g) rregulloret, procedurat dhe kontrollet për përfshirjen e emetuesit ose ndërmjetësit në proces.

SHTOJCA VIII

PAVARËSIA DHE SHMANGIA E KONFLIKTEVE TË INTERESIT

Informacioni lidhur me identifikimin, menaxhimin dhe deklarimin e konflikteve të interesit dhe rregullat mbi analistët e vlerësimit të rrezikut, si dhe personat e përfshirë në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit mbulon:

- (a) identifikimin, parandalimin, deklarimin dhe zbutjen e konflikteve të interesit që lindin nga lëshimi i vlerësimeve të rrezikut të kreditit ose ofrimit të shërbimeve ndihmëse, të parashikuara në pikën 1, të Pjesës B, të Shtojcës XIII;
 - (b) ndarjen nga procesi i vlerësimit të rrezikut të diskutimeve mbi tarifatat e marra nga subjektet e vlerësuara dhe palët e treta të lidhura, në mënyrë që të sigurohet që analistët vlerësues, punonjësit e saj dhe çdo person tjetër fizik shërbimet e të cilit vihen në dispozicion të saj ose nën kontrollin e saj dhe që janë të përfshirë drejtpërdrejt në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit nuk do të lejohen të nisin apo të marrin pjesë në bisedime për tarifa ose pagesa me asnjë subjekt të vlerësuar, palë të treta të lidhura ose asnjë person që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me subjektin e vlerësuar përmes kontrollit;
 - (c) përcaktimin e tarifave të vendosura nga agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit për subjektet e vlerësuara dhe palët e treta të lidhura; kontrollin e informacionit të fshehtë të përftuar apo të ndarë me të gjitha subjektet e vlerësuara, palët e treta të lidhura dhe individë të tjerë përkatës, sipas përcaktimeve në pikën 3, të Pjesës C, të Shtojcës XIII;
 - (d) kriteret e përcaktuara në pikën 2, të Pjesës C, të Shtojcës XIII lidhur me tregtimin e titujve të vlerësuar nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ose, që përmbajnë informacion mbi mënyrën sesi agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit identifikon, për çdo vlerësim të përcaktuar të rrezikut të kreditit, punonjësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të rrezikut në çdo nivel dhe funksion;
 - (e) kriteret e përcaktuara në pikën 4, të Pjesës C, të Shtojcës XIII lidhur me pranimin e parave, dhuratave ose favoreve dhe
 - (f) rregullat mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së analistit të vlerësimit të rrezikut, parashikuar në pikat 6 dhe 7 të Pjesës C, të Shtojcës XIII.
-

SHTOJCA IX

PROGRAMI I VEPRIMTARISË OPERACIONALE

Koncepti i punës/zhvillimi i punës

1. Informacioni vijues lidhur me veprimtaritë e punës së agjencive të vlerësimit të rrezikut të kreditit:
 - (a) një përshkrim i mjedisit makroekonomik në të cilin pritet të veprojë agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit;
 - (b) një përshkrim i planeve të ardhshme për ngritjen e shoqërive të kontrolluara ose degëve dhe vendndodhjet e tyre dhe
 - (c) një përshkrim i veprimtarive të punës që agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit synon të zhvillojë, duke përmendur konkretisht veprimtaritë e shoqërive të kontrolluara dhe të degëve. Informacioni përfshin klasat e vlerësimeve të rrezikut të kreditit, klientët e mundshëm dhe veprimtaritë që nuk lidhen me vlerësimin.

Klasa e vlerësimeve të rrezikut të kreditit

2. Informacioni vijues lidhur me klasën e vlerësimeve të rrezikut të kreditit:
 - (a) Detaje nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit planifikon të nxjerrë vlerësime të kërkuara apo të pakërkuara të rrezikut ose të dyja;
 - (b) një vlerësim i raportit midis vlerësimeve publike dhe private të rrezikut për secilën klasë të vlerësimit të planifikuar për t'u nxjerrë nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit,
 - (c) numrin e vlerësimeve publike/sovrane;
 - (d) numrin dhe vëllimin të vlerësimeve të rrezikut të instrumenteve të strukturuar financiare;
 - (e) numrin dhe vëllimin të vlerësimeve të rrezikut të korporatës, me detajet vijuese: institucionet financiare, sigurimet, emetuesit korporativ dhe
 - (f) numrin mesatar të vlerësimeve të rrezikut të kreditit të kryera ose të monitoruara për punonjës, të paraqitura sipas klasës së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Plani financiar

3. Projektionet për:
 - (a) bilancin dhe
 - (b) pasqyrën e të ardhurave.
4. Në planifikimet e të ardhurave, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ndan të ardhurat nga veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit nga shërbimet ndihmëse të saj. Nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka planifikuar ose planifikon të hapë degë, të shënohen të ardhurat nga secila degë.

Qeverisja korporative

5. Numri i anëtarëve në organet vijuese:

- (a) këshilli i administrimit dhe këshilli mbikëqyrës dhe
- (b) anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit dhe këshillit mbikëqyrës.

Delegimi

6. Një përshkrim i veprimtarive të planifikuara për t'u deleguar, identifikimi i subjekteve të cilat planifikohet të delegohen veprimtaritë, si dhe një shpjegim të arsyeve për delegimin. Të përcaktohet nëse ndonjë veprimtari delegohet nga një degë.

Burimet njerëzore/personeli

7. Numri i punonjësve të përhershëm e të përkohshëm që punojnë në funksionet e mëposhtme dhe vjetërsia e tyre:

- (a) funksionarë kryesorë që nuk janë anëtarë të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës dhe persona të emëruar për të drejtuar degët;
- (b) funksioni i auditimit;
- (c) mekanizmi i brendshëm i kontrollit;
- (d) funksioni i përputhshmërisë dhe
- (e) funksioni i rishikimit.

8. Informacioni në vijim:

- (a) numri i punonjësve për funksion/departament;
- (b) numri i punonjësve të përkohshëm dhe numri i punonjësve të përhershëm të kontraktuar nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të përfshirë në aktivitetin e vlerësimit të rrezikut;
- (c) numri i punonjësve të përkohshëm dhe numri i punonjësve të përhershëm të kontraktuar nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të përfshirë në shërbimet ndihmëse;
- (d) numri i punonjësve që miratojnë vlerësimet e rrezikut të kreditit, si kryetarët e komisioneve, analistët vlerësues dhe analistët kryesorë vlerësues, sëbashku me të dhëna mbi:
 - (i) vjetërsinë ose gradën e tyre;
 - (ii) llojin e analistit vlerësues, përfshi, sipas rastit, faktin nëse punonjësi është analist parësor ose mbikëqyrës dhe analist cilësor ose sasior dhe
 - (iii) numrin e viteve të përvojës në agjencinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit ose në sektorin e vlerësimit të rrezikut të kreditit.

SHTOJCA X

MBAJTJA E TË DHËNAVE, PLANIFIKIMI PËR VIJIMËSINË E AKTIVITETIT DHE SISTEMET E INFORMACIONIT

Mbajtja e të dhënave

1. Informacion mbi rregulloret dhe procedurat në lidhje me detyrimet për mbajtjen e të dhënave, parashikuar në pikën 7 të Pjesës A dhe pikave 7, 8 dhe 9 të Pjesës B të Shtojcës XIII:

- (a) një përshkrim mbi mbajtjen e të dhënave dhe kohën e ruajtjes së tyre
- (b) identifikimi i marrësve të informacionit konfidencial për çdo vlerësim të rrezikut të kreditit.

Vijimësia dhe rregullsia e aktivitetit

2. Informacion mbi vijimësinë dhe rregullsinë e kryerjes së veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, sipas përcaktimeve në pikën 8, të Pjesës A, të Shtojcës XIII, përfshi:

- (a) përshkrimin e procedurave për të siguruar vijimësinë dhe rregullsinë e kryerjes së veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi të dhëna rreth zbatimit të tyre për ofruesit e shërbimeve të cilëve iu janë deleguar veprimtaritë;
- (b) llojet e testeve të planifikimit të vijimësisë së aktivitetit që pritet të zhvillohen dhe
- (c) shpeshësinë e testimit.

Sistemet e përpunimit të informacionit

3. Informacioni mbi sistemet e përpunimit të informacionit, sipas parashikimeve në pikën 8, të Pjesës A, të Shtojcës XIII, përfshin:

- (a) identitetin e funksionarit kryesor përgjegjës për sistemet e përpunimit të informacionit;
- (b) një përshkrim të sistemeve të përpunimit të informacionit, përfshi sistemet mbështetëse (back-up) dhe
- (c) një përshkrim të kontrollit efektiv dhe rregullave mbi garancinë e sistemeve ekzistuese të përpunimit të informacionit, si dhe mekanizmat për monitorimin e efektivitetit të tyre, përfshi detajet mbi procedurat ekzistuese për të siguruar një ndarje efektive midis sistemeve të përpunimit të informacionit të përdorura për të raportuar tarifën nga ato ku kanë qasje analistët vlerësues të rrezikut të kreditit dhe që përdoren për të regjistruar vlerësimet dhe të dhënat mbi subjektet apo transaksionet e vlerësuara.

SHTOJCA XI

MIRATIMI I VLERËSIMIT

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të vendeve të treta

1. Informacioni vijues për çdo agjenci përkatëse të vlerësimit të rrezikut të kreditit të vendeve të treta:
 - (a) emrin e saj të plotë;
 - (b) statusi juridik, përfshi ekstraktin nga regjistri tregtar përkatës ose dokumentin mbi vendin e themelimit dhe fushën e veprimtarisë tregtare ose detaje të tjera të regjistrimit të shoqërisë;
 - (c) vendin e themelimit;
 - (d) adresën e selisë së regjistruar;
 - (e) të dhënat që agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të vendit të tretë është e autorizuar ose e regjistruar dhe është subjekt i mbikëqyrjes në juridiksionin përkatës;
 - (f) klasën e vlerësimit të rrezikut të kreditit që agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit pritet të miratojë dhe
 - (g) numrin e analistëve që punëson.
2. Një diagrame organizative të pronësisë të secilës agjencie të vlerësimit të rrezikut të kreditit, të shoqërive të tyre kontrolluara, degëve, shoqërisë mëmë dhe shoqërive të kontrolluara nga shoqëria mëmë në procesin e nxjerrjes së vlerësimit për të cilin është parashikuar miratimi.

Vlerësimi i regjimit rregullator të vendit të tretë

3. Në lidhje me juridiksionin përkatës të vendit të tretë, informacione të hollësishme, analizë të strukturuar dhe arsyetimin për çdo kriter, përfshi çdo referencë ndaj pjesëve përkatëse të legjislacionit/rregulloreve të vendit të tretë.
4. Detyrimi që parashikohet në nënparagrafin e parë të kësaj pike nuk gjen zbatim kur Autoriteti vlerëson se kriteret e regjimit të vendit të tretë janë po aq rigorozë sa edhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

Procedurat për monitorimin e sjelljes

5. Një përshkrim i masave të marra nga agjencia miratuese të vlerësimit të rrezikut të kreditit për monitorimin se agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit e vendit të tretë i përmbush këto kritere dhe për të monitoruar problemet e mundshme të identifikuar nga agjencia miratuese e vlerësimit të rrezikut të kreditit sa i takon përmbushjes së këtyre kritereve.

Arsyet objektive

6. Një përshkrim të arsyeve objektive për vlerësimet e rrezikut të kreditit që do të nxirren nga vendi i tretë.

Legjislacioni në vendin e tretë

7.Evidencë që autoritetet publike nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në përmbajtjen e vlerësimeve të rrezikut të kreditit dhe metodikat e përdorura nga agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit të themeluara në secilin juridiksion përkatës të vendit të tretë.

SHTOJCA XII

TREGUESIT ME RËNDËSI SISTEMIKE

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i paraqet Autoritetit vëllimin e vlerësimeve të përcaktuara të rrezikut të kreditit me detaje të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Informacionet lidhur me vlerësimin e rrezikut korporativ dhe vlerësimet sovran dhe të financave publike paraqiten mbi bazën e numrit të vlerësimeve të rrezikut të kreditit dhe informacionet lidhur me vlerësimet e rrezikut të financimit të strukturuar jepen në bazë të vlerës së nxjerrjes së instrumenteve të strukturuar financiare.

	Gjithsej
Vlerësimet e rrezikut korporativ (numri i vlerësimeve të rrezikut të kreditit)	
Institucioni financiar përfshi institucionet e kreditit dhe shoqëritë komisionere	
Shoqëritë e sigurimeve	
Emetuesi korporativ që nuk konsiderohet institucion financiar ose shoqëri sigurimi	
Vlerësimet e rrezikut sovran dhe të financave publike (numri i vlerësimeve të rrezikut të kreditit)	
Vlerësimet e rrezikut të financimit të strukturuar (vlera e nxjerrjes)	

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ofron informacion mbi të ardhurat vjetore që merren në secilin vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera jashtë Bashkimit Evropian për tri vitet e kaluara në nivelin e detajeve të mëposhtme:

	Vendi anëtar i BE-së 1	Vendi anëtar i BE-së 2	Vendi anëtar i BE-së 3	(...)	Vende të tjera joanëtare të BE-së	Gjithsej
Veprimtaritë e vlerësimit						
Nga subjektet e vlerësuara ose nga palët e treta të lidhura						
Nga nënshkruesit						
Burime të tjera						

Veprimtaritë që nuk lidhen me vlerësimin						
---	--	--	--	--	--	--

Vendet anëtare identifikohen individualisht.

SHTOJCA XIII

PAVARËSIA DHE SHMANGIA E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Pjesa A

Kriteret organizative

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ka një këshill administrimi ose këshill mbikëqyrës. Funkionarët e saj kryesorë sigurojnë që:

- (a) veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit të jenë të pavarura, përfshi të gjitha ndikimet ose kufizimet politike dhe ekonomike;
- (b) konfliktet e interesit të identifikohen, menaxhohen dhe të bëhen të ditura në mënyrën e duhur;
- (c) agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të veprojnë në përputhje me kriteret e kësaj Rregulloreje.

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit organizohet në mënyrë të tillë që të sigurohet se interesat e aktivitetit të saj nuk cenojnë pavarësinë ose saktësinë e veprimtarive të vlerësimeve të rrezikut të kreditit.

Funkionarët kryesorë të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit kanë emër të mirë dhe janë të aftë e me përvojë të mjaftueshme, si dhe sigurojnë drejtimin e shëndoshë e të kujdesshëm të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Të paktën një e treta e anëtarëve, por jo më pak se dy, të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit janë anëtarë të pavarur, të cilët nuk janë të përfshirë në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Shpërblimi i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës nuk lidhet me rezultatet e aktivitetit të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe vendoset në mënyrë të tillë që të sigurojë pavarësinë e gjykimit të tyre. Anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës qëndrojnë në detyrë për një afat të caktuar të rënë dakord më parë prej jo më shumë se pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje. Shkarkimi i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës ndodh vetëm në raste sjelljeje të papërshtatshme apo rezultateve të ulëta profesionale.

Shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, përfshi anëtarët e tyre të pavarur, zotërojnë ekspertizë të mjaftueshme në shërbimet financiare. Me kusht që agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të nxjerrë vlerësime të rrezikut të kreditit të instrumenteve të strukturuar financiare, të paktën një anëtar i pavarur dhe një anëtar tjetër i këshillit duhet të kenë njohuri të thelluara dhe përvojë të nivelit të lartë të tregjeve për instrumentet e strukturuar financiare.

Përveç përgjegjësisë së përgjithshme të këshillit, anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës kanë detyrë konkrete të monitorojnë:

- (a) hartimin e politikës së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe të metodikave të përdorura nga agjencia e vlerësimit në veprimtaritë e saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit;
- (b) efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit në raport me veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit;

(c)efektivitetin e masave dhe procedurave të hartuara, që sigurojnë që çdo konflikt interesi të identifikohet, eliminohet ose të menaxhohet dhe deklarohet dhe

(d)proceset e përmbushjes dhe qeverisjes, përfshi efikasitetin e funksionit të rishikimit përmendur në pikën 9 të kësaj Pjese.

Mendimet e anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës për çështjet që përmenden në pikat (a) deri në (d) i paraqiten periodikisht këshillit dhe i vihen në dispozicion autoritetit kompetent, kur kërkohen.

3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit miraton rregullore dhe procedura të mjaftueshme për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të saj në përputhje me këtë Rregullore.

4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit disponon procedura administrimi dhe kontabiliteti të shëndosha, mekanizma kontrolli të brendshëm, procedura efektive për vlerësimin e rrezikut dhe masa efektive kontrolli dhe garancie për sistemet e përpunimit të informacionit.

Këta mekanizma të brendshëm kontrolli konceptohen për të siguruar përmbushjen me vendimet dhe procedurat e të gjitha niveleve të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit zbaton dhe mban procedurat vendimmarrëse dhe strukturat organizative që tregojnë qartë e në mënyrë të dokumentuar linjat e raportimit dhe përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë.

5. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit krijon dhe mban një departament të përhershëm dhe efektiv të funksionit të përputhshmërisë (funksioni i përputhshmërisë apo *compliance*), i cili vepron në mënyrë të pavarur. Funkzioni i përputhshmërisë monitoron dhe raporton mbi përmbushjen nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe punonjësit e saj të detyrimeve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Funksioni i përputhshmërisë:

(a)monitoron dhe vlerëson rregullisht mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e masave dhe të procedurave të miratuara në përputhje me pikën 3 dhe masat e marra për trajtimin e mangësive në përmbushjen me detyrimet e saj të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit;

(b)këshillon dhe ndihmon drejtuesit, analistët vlerësues, punonjësit, si dhe çdo person tjetër fizik shërbimet e të cilit janë vendosur në dispozicion ose nën kontrollin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ose çdo person i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me të përmes kontrollit, i cili/e cila është përgjegjës/e për kryerjen e veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, të përmbushin detyrimet e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit të përcaktuara në këtë Rregullore.

6.Me qëllim që funksioni i përputhshmërisë të përmbushë si duhet dhe në mënyrë të pavarur përgjegjësitë e tij, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohet që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

(a)funksioni i përputhshmërisë ka kompetencat, burimet, ekspertizën dhe qasjen në të gjitha informacionet përkatëse;

(b) caktohet një person përgjegjës i përputhshmërisë, që është përgjegjës për funksionin e përputhshmërisë dhe për çdo raportim që lidhet me përputhshmërinë, përcaktuar në pikën 3;

(c) drejtuesit, analistët vlerësues të rrezikut, punonjësit si dhe çdo person tjetër fizik shërbimet e të cilit janë vendosur në dispozicion ose nën kontrollin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ose çdo person i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me të përmes kontrollit, i cili/e

cila është përfshirë në funksionin e përputhshmërisë, nuk është i angazhuar në kryerjen e veprimtarive të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit që monitorojnë;

(d)shpërblimi i personit përgjegjës të përputhshmërisë nuk lidhet me rezultatet e aktivitetit tregtar të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe vendoset në mënyrë të tillë që të sigurojë pavarësinë e gjykimit të tij/të saj.

Personi përgjegjës i përputhshmërisë sigurohet që çdo konflikt interesi i cili ka lidhje me personat e vendosur në dispozicion të funksionit të përputhshmërisë të identifikohen dhe të eliminohen në mënyrën e duhur.

Personi përgjegjës i përputhshmërisë raporton rregullisht për kryerjen e detyrave të tij/të saj te funksionarët kryesorë drejtues dhe anëtarët e pavarur të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës.

7. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit miraton rregulla të përshtatshme dhe efektive organizative dhe administrative, për të parandaluar, identifikuar, eliminuar ose menaxhuar dhe deklaruar çdo konflikt interesi të përmendur pikën 1, të Pjesës B. Ajo siguron mbajtjen e të dhënave për çdo kërcënim të rëndësishëm ndaj pavarësisë së veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi ato ndaj rregullave për analistët vlerësues të parashikuara në Pjesën C, si dhe garancitë e zbatuara për të zbutur këto kërcënime.

8. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit përdor sistemet, burimet dhe procedurat e duhura për të siguruar vijimësinë dhe rregullsinë e kryerjes së veprimtarive të saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit.

9. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ngre një funksion rishikimi për të rishikuar periodikisht metodikat, modelet dhe supozimet kyçe të vlerësimit të rrezikut, si supozimet matematikore ose të korrelacioneve, dhe ndryshimet ose modifikimet e tyre, si dhe përshtatshmërinë e këtyre metodikave, modeleve dhe supozimeve kyçe të vlerësimit të rrezikut kur ato përdoren ose synojnë të përdoren për vlerësimin e instrumenteve të reja financiare.

Ky funksion rishikimi është i pavarur nga linjat e punës që janë përgjegjëse për veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut kreditit dhe u raporton anëtarëve të këshillit të administrimit dhe këshillit mbikëqyrës, përmendur në pikën 2 të kësaj Pjese.

10. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit monitoron dhe vlerëson mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të saj, mekanizmave dhe rregullave të kontrollit të brendshëm të miratuara në përputhje me këtë Rregullore dhe merr masat e duhura për trajtimin e çdo mangësie.

Pjesa B

Kërkesat operative

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit identifikon, eliminon ose menaxhon e deklaron qartë dhe dukshëm çdo konflikt faktik ose të mundshëm interesi që mund të ndikojë në analizat dhe gjykimet e analistëve të saj të vlerësimit të rrezikut, punonjësve ose çdo personi tjetër fizik shërbimet e të cilit janë vendosur në dispozicion ose nën kontrollin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe që janë drejtpërdrejt të përfshirë në nxjerrjen e vlerësimit të rrezikut të kreditit, si dhe personave që miratojnë vlerësimet e rrezikut të kreditit.

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit deklarohet publikisht emrat dhe subjektet e vlerësuar ose palët e treta të lidhura nga të cilat merr më shumë sesa 5 % të të ardhurave të saj vjetore.

3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit nuk nxjerr vlerësimin e rrezikut të kreditit në asnjë nga rrethanat vijuese ose, në rast të një vlerësimi ekzistues të rrezikut të kreditit, deklaron se kur mund të ndikohet vlerësimi i rrezikut të kreditit nga sa vijon:

- (a) agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit ose personat e përmendur në pikën 1 zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi instrumente financiare të subjektit të vlerësuar ose të një palë të tretë të lidhur ose kanë interesa të tjera të drejtpërdrejta ose të tërthorta te ky subjekt apo kjo palë, përveç pjesëmarrjeve në skemat e diversifikuara të investimit kolektiv, përfshi fondet e administruara, si fondet e pensioneve apo të sigurimit të jetës;
- (b) vlerësimi i rrezikut të kreditit nxirret lidhur me subjektin e vlerësuar apo një palë të tretë që është drejtpërdrejt ose tërthorazi e lidhur me agjencinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit përmes kontrollit;
- (c) personi i përmendur në pikën 1 është anëtar i këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës të subjektit të vlerësuar apo të një palë të tretë të lidhur ose
- (d) një analist i vlerësimit të rrezikut që ka marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të kreditit ose një person i cili miraton vlerësimin e rrezikut të kreditit ka pasur marrëdhënie me subjektin e vlerësuar ose me një palë të tretë të lidhur, që mund të shkaktojë konflikt interesi.

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit vlerëson menjëherë nëse ka baza për rivlerësimin e rrezikut ose tërheqjen e vlerësimit ekzistues të rrezikut të kreditit.

4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit nuk i ofron konsulencë apo shërbime këshillimi subjektit të vlerësuar apo një palë të tretë të lidhur mbi strukturën korporative ose ligjore, aktivet ose pasivet e këtij subjekti të vlerësuar apo palës së tretë të lidhur.

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit mund të ofrojë shërbime të tjera përveç nxjerrjes së vlerësimeve të rrezikut të kreditit (shërbime ndihmëse). Shërbimet ndihmëse nuk janë pjesë e veprimtarive të vlerësimit të kreditit; aty përfshihen parashikimet e tregut, vlerësimet e prirjeve ekonomike, analiza e çmimeve dhe analiza të tjera të përgjithshme të të dhënave, si dhe shërbimet përkatëse të shpërndarjes.

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohet që ofrimi shërbimeve ndihmëse të mos jetë në konflikt interesi me veprimtaritë e saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe deklaron në raportet përfundimtare të vlerësimit çdo shërbim ndihmës të ofruar për subjektin e vlerësuar ose çdo palë të lidhur.

5. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohet që analistët vlerësues ose personat që miratojnë vlerësimet të mos bëjnë propozime apo rekomandime, qoftë zyrtarisht ose jozyrtarisht, lidhur me përbërjen e instrumenteve të strukturuar financiare mbi të cilat pritet që agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit të mbështetë vlerësimin e rrezikut.

6. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit përcakton kanalet e saj të raportimit dhe të komunikimit, me qëllim që të sigurojë pavarësinë e personave të përmendur në pikën 1 nga veprimtari të tjera të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit të kryera mbi baza tregtare.

7. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit merr masa për mbajtjen e të dhënave dhe, kur e nevojshme, informacione gjurmuese të auditimit të veprimtarive të saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit. Këto të dhëna përfshijnë:

- (a) për çdo vendim vlerësimi të rrezikut të kreditit, identitetin e analistëve vlerësues që marrin pjesë në përcaktimin e vlerësimit të rrezikut të kreditit, identitetin e personave që kanë miratuar vlerësimin e rrezikut të kreditit, informacion mbi faktin nëse vlerësimi i rrezikut të kreditit ishte

i kërkuar ose i pakërkuar dhe datën në të cilën është ndërmarrë veprimi i vlerësimit të rrezikut të kreditit;

- (b) të dhënat kontabël që lidhen me tarifat e marra nga subjektet e vlerësuara ose palët e treta të lidhura ose çdo përdorues i vlerësimeve;
- (c) të dhënat kontabël për secilin abonent të vlerësimeve të rrezikut të kreditit apo shërbimeve të lidhura me to;
- (d) të dhëna që dokumentojnë procedurat e miratuara dhe metodikat e përdorura nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit për të përcaktuar vlerësimet e rrezikut të kreditit;
- (e) të dhënat dhe skedarët e brendshëm, përfshi informacionet jopublike dhe dokumentet e punës që janë përdorur për marrjen e çdo vendimi lidhur me vlerësimin e rrezikut të kreditit;
- (f) raportet e analizës së kreditit, raportet e vlerësimit të kreditit dhe raportet private të vlerësimit të rrezikut të kreditit, si dhe të dhënat e brendshme, përfshi informacionet jopublike dhe dokumentet e punës që janë përdorur për të krijuar bazën përmendimet e shprehura në këto raporte;
- (g) të dhëna për procedurat dhe masat e zbatuara nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit për zbatim të kësaj Rregulloreje dhe
- (h) kopje të komunikimeve të brendshme dhe të jashtme, përfshi komunikimet elektronike të marra dhe të dërguara nga agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe punonjësit e saj, që lidhen me veprimtaritë e vlerësimit.

8. Të dhënat dhe gjurmimet e auditimit, të përmendura në pikën 7, mbahen në mjediset e agjencisë së regjistruar të vlerësimit të rrezikut të kreditit për të paktën pesë vjet dhe i vihen në dispozicion Autoritetit, sipas kërkesës.

Kur tërhiqet regjistrimi i agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, të dhënat mbahen për një periudhë shtesë prej të paktën tre vitesh.

9. Të dhënat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet përkatëse të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe subjektit të vlerësuar ose palëve të treta të lidhura me, në bazë të një marrëveshjeje për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të rrezikut të kreditit, ruhen të paktën për kohëzgjatjen e marrëdhënies me këtë subjekt të vlerësuar apo palët e treta të lidhura.

Pjesa C

Rregullat për analistët vlerësues dhe persona të tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit

1. Analistët vlerësues të rrezikut të kreditit, punonjësit e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, si dhe çdo person tjetër fizik shërbimet e të cilit janë vendosur në dispozicion ose nën kontrollin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe që është i përfshirë drejtpërdrejt në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe personat e lidhur ngushtë me ta, nuk blejnë ose shesin apo angazhohen në asnjë transaksion me asnjë instrument financiar të emtuar, të garantuar ose të mbështetur tjetërsoj nga një subjekt i vlerësuar në fushën e përgjegjësisë së tyre kryesore analitike, përveç pjesëmarrjeve në skemat e diversifikuara të investimit kolektiv, përfshi fondet e administruara, si fondet e pensionit ose sigurimi i jetës.

2. Asnjë person i përmendur në pikën 1 nuk merr pjesë apo ndikon në vendosjen e një vlerësimi të rrezikut të kreditit të një subjekti të caktuar vlerësimi, nëse ky person:

- (a) zotëron instrumente të subjektit të vlerësuar përveç pjesëmarrjeve në skemat e diversifikuara të investimit kolektiv;
- (b) zotëron instrumente financiare të ndonjë subjekti që ka lidhje me një subjekt të vlerësuar, zotërimi i të cilave mund të shkaktojë ose mund të perceptohet përgjithësisht se shkakton një konflikt interesi, përveç pjesëmarrjeve në skemat e diversifikuara të investimit kolektiv;
- (c) ka pasur marrëdhënie punësimi, biznesi ose marrëdhënie të llojeve të tjera së fundi me subjektet e vlerësuar, që mund të shkaktojë ose mund të perceptohet përgjithësisht se shkakton një konflikt interesi.

3. Agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohen që personat e përmendur në pikën 1:

- (a) Marrin të gjitha masat e arsyeshme për të mbrojtur pasuritë dhe të dhënat që ka në zotërim agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit nga mashtrimi, vjedhja ose keqpërdorimi, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre tregtare dhe natyrën dhe gamën e veprimtarive të tyre të vlerësimit të rrezikut të kreditit;
- (b) nuk japin asnjë informacion mbi vlerësimet e rrezikut të kreditit ose vlerësimet e ardhshme të rrezikut të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, me përjashtim të subjektit të vlerësuar ose palës së tretë të lidhur me të;
- (c) nuk ndajnë të dhëna të fshehta që i janë besuar agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit me analistë vlerësimi dhe punonjës të asnjë personi që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me të përmes kontrollit, si dhe me asnjë person tjetër fizik shërbimet e të cilit janë vendosur në dispozicion ose nën kontrollin e personave të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me të përmes kontrollit dhe i cili/e cila është i/e përfshirë drejtpërdrejt në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe
- (d) nuk përdorin ose ndajnë informacione të fshehta për qëllime tregtimi të instrumenteve financiare ose për çdo qëllim tjetër përveç kryerjes së veprimtarive të vlerësimit të rrezikut të kreditit.

4. Personat e përmendur në pikën 1 nuk kërkojnë ose pranojnë para, dhurata ose favore nga askush me të cilin agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit bën biznes.

5. Nëse një person i përmendur në pikën 1 vlerëson se persona të tillë të tjerë janë angazhuar në sjellje që ai ose ajo i konsideron të paligjshme, ai ose ajo ia raporton këtë informacion menjëherë personit përgjegjës të përputhshmërisë, pa pasur asnjë pasojë negative mbi të.

6. Kur një analist vlerësimi ndërpret marrëdhëniet e punës dhe bashkohet me një subjekt të vlerësuar, në vlerësimin e të cilit është përfshirë ose me një subjekt financiar me të cilin ka pasur marrëdhënie tregtare si pjesë e detyrës si tij/të saj në agjencinë e vlerësimit të rrezikut të kreditit, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit rishikon punën përkatëse të analistit të vlerësimit përgjatë dy viteve të fundit përpara largimit të tij ose të saj.

7. Personi i përmendur në pikën 1 nuk merr asnjë pozicion kryesor drejtues në subjektin e vlerësuar ose palën e tretë të lidhur me të brenda gjashtë muajve nga vlerësimi i rrezikut të kreditit.

8. Agjencitë e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohen që:

- (a) analistët kryesorë të vlerësimit të rrezikut nuk përfshihen në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit që lidhen me të njëjtin subjekt të vlerësuar ose palën e tretë të lidhur me të për një periudhë mbi katër vjet;
- (b) analistët vlerësues nuk përfshihen në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit që lidhen

- me të njëjtin subjekt të vlerësuar ose me palët e treta të lidhura për një periudhë mbi pesë vjet;
- (c) personat që miratojnë vlerësimin e rrezikut të kreditit nuk përfshihen në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit që kanë të bëjnë me të njëjtin subjekt të vlerësuar ose me palët e treta të lidhura për një periudhë mbi shtatë vjet.

Personat e përmendur në pikat (a), (b) dhe (c) të nënparagrafit të parë nuk përfshihen në veprimtaritë e vlerësimit të rrezikut të kreditit të subjektit të vlerësuar ose të palëve të treta të lidhura që përmenden në këto pika për një periudhë dy vjeçare pas përfundimit të afateve të përcaktuara në këto pika.

Pjesa D

Rregullat për prezantimin e vlerësimeve të rrezikut të kreditit

I. Detyrime të përgjithshme

1. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohet që çdo vlerësim i rrezikut të kreditit të paraqesë qartë dhe dukshëm emrin dhe pozicionin e punës së analistit kryesor të vlerësimit të rrezikut në një veprimtari të dhënë të vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe emrin dhe pozicionin e personit që ka përgjegjësi kryesore për miratimin e vlerësimit të rrezikut të kreditit.
2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit sigurohet që, të paktën:
 - (a) të paraqiten të gjitha burimet e rëndësishme materiale, përfshi subjektet e vlerësuara ose, sipas rastit, palën e tretë, që janë përdorur për përgatitjen e vlerësimit të rrezikut të kreditit, së bashku me informacionin nëse vlerësimi i rrezikut të kreditit i është bërë me dije këtij subjekti të vlerësuar ose palës së tretë të lidhur dhe nëse është ndryshuar pas bërjes me dije, përpara sesa të nxirret;
 - (b) të përshkruhet qartë metodika kryesore ose varianti metodik i përdorur për përcaktimin e vlerësimit të rrezikut të kreditit, duke përfshirë një referencë për përshkrimin e plotë; kur vlerësimi i rrezikut të kreditit mbështetet mbi më shumë sesa një metodikë ose kur referenca vetëm për metodikën kryesore mund të bëjë që investuesve t'u shpëtojnë aspekte të tjera të rëndësishme të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi korrigjime ose devijime domethënëse, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit e shpjegon këtë fakt në vlerësimin e rrezikut të kreditit dhe tregon sesi metodikat e ndryshme ose këto aspekte të tjera merren parasysh në vlerësimin e rrezikut të kreditit;
 - (c) të shpjegohet kuptimi i çdo kategorie vlerësimi, përkufizimi i mospërmbushjes ose rimëkëmbjes dhe çdo paralajmërimi të nevojshëm rreziku, përfshi analizën e ndjeshmërisë së supozimeve kyçe të vlerësimit të rrezikut, si supozimet matematikore ose korrelative, të shoqëruara nga skenari më i keq i vlerësimeve të rrezikut të kreditit dhe nga skenari më i mirë i vlerësimit të rrezikut të kreditit;
 - (d) të shënohet qartë dhe dukshëm data në të cilën vlerësimi i rrezikut të kreditit është nxjerrë për herë të parë për shpërndarje dhe kur është përditësuar për herë të fundit dhe
 - (e) të jepet informacion mbi faktin nëse vlerësimi i rrezikut të kreditit ka të bëjë me një instrument financiar të sapoemeluar dhe nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit e vlerëson për herë të parë instrumentin financiar.
3. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit informon subjektin e vlerësuar të pakën 12 orë

përpara publikimit të vlerësimit të rrezikut të kreditit për argumentet kryesore mbi të cilat është bazuar vlerësimi, me qëllim që t'i japë subjektit mundësinë për t'i sjellë në vëmendje agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit ndonjë gabim faktik.

4. Kur njofton vlerësimet e rrezikut të kreditit, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit paraqet qartë dhe dukshëm tiparet dhe kufizimet e vlerësimit të rrezikut të kreditit. Veçanërisht, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit deklaron qartë nëse e konsideron të kënaqshme cilësinë e informacionit të vlefshëm mbi subjektin e vlerësuar dhe në ç'shikallë ka verifikuar informacionin që i është paraqitur nga subjekti i vlerësuar ose pala e tretë e lidhur me të. Nëse vlerësimi i rrezikut të kreditit përfshin një lloj subjekti ose instrumenti financiar për të cilin të dhënat historike janë të kufizuara, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit i bën të qarta, në një vend të dukshëm, këto kufizime të vlerësimit të rrezikut të kreditit.

Në rastin kur mungesa e të dhënave të besueshme ose kompleksiteti i një lloji të ri instrumenti financiar ose cilësia e informacionit të vlefshëm nuk është e kënaqshme ose ngre pikëpyetje serioze nëse agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit mund të ofrojë një vlerësim të besueshëm të rrezikut, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit nuk e publikon vlerësimin e rrezikut të kreditit ose tërheq vlerësimin ekzistues të rrezikut.

5. Kur shpall vlerësimin e rrezikut të kreditit, agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit shpjegon në deklaratat për shtyp ose raportet e saj elementet kyçe mbi të cilat bazohet ky vlerësim.

Kur informacioni i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 4 është shpërpjesëtimor në raport me madhësinë e raportit të shpërndarë, duhet të jetë i mjaftueshëm për të ofruar referenca të qarta e të dukshme ku mund të konsultohen drejtpërdrejt dhe lehtësisht këto njoftime në raport, duke përfshirë një adresë të drejtpërdrejtë të njoftimit në faqen e duhur të internetit të agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit.

II. Detyrimet shitesë në lidhje me vlerësimet e rrezikut të kreditit të instrumenteve të strukturuar financiare

1. Kur agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit vlerëson një instrument të strukturuar financiar, ajo paraqet në vlerësimin e rrezikut të kreditit të gjithë informacionin mbi analizën e humbjeve dhe të fluksit të mjeteve monetare që ka kryer ose mbi të cilën është mbështetur, si dhe një përshkrim të çdo ndryshimi të pritshëm në vlerësimin e rrezikut të kreditit.

2. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit informon mbi nivelin e vlerësimit që ka kryer lidhur me proceset e vigjilencës së duhur të zhvilluara në nivelin e instrumenteve financiare përbërëse ose aktive të tjera të instrumenteve të strukturuar financiare. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit njofton nëse ka ndërmarrë ndonjë vlerësim të këtyre proceseve të vigjilencës së duhur ose nëse është mbështetur në vlerësimin e palëve të treta, duke përshkruar sesi e ka ndikuar vlerësimin e rrezikut të kreditit ky vlerësim.

3. Kur agjencia e vlerësimit të kreditit nxjerr vlerësimet e rrezikut të kreditit të instrumenteve të strukturuar financiare, ajo i shoqëron informacionet për metodikat, modelet dhe supozimet kyçe të vlerësimit me një udhëzues që shpjegon supozimet, parametrat, kufijtë dhe pasiguritë që shoqërojnë modelet dhe metodikat e vlerësimit të përdorura në këto vlerësime të rrezikut të kreditit, përfshi simulimet e skenarëve të stresit të kryera nga agjencitë kur përcaktojnë vlerësimet e rrezikut. Ky udhëzues është i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm.

4. Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit jep vazhdimisht informacione rreth të gjitha produkteve të strukturuar financiare që i janë paraqitur për shqyrtim fillestar apo vlerësim paraprak. Ky informacion jepet pavarësisht nëse emetuesit lidhin kontratë me agjencinë e

vlerësimin të rrezikut të kreditit për një vlerësim përfundimtar.

Pjesa E

Dhënia e informacionit

I. Informacione të përgjithshme

Agjencia e vlerësimin të rrezikut të kreditit ofron përgjithësisht informacion për faktin që është regjistruar në përputhje me këtë Rregullore dhe si dhe informacionet në vijim:

1. çdo konflikt faktik dhe të mundshëm interesi që përmendet në pikën 1 të Pjesës B;
2. një listë të shërbimeve ndihmëse;
3. politikën e agjencisë së vlerësimin të kreditit lidhur me publikimin e vlerësimeve të rrezikut të kreditit dhe komunikime të tjera përkatëse;
4. natyrën e përgjithshme të rregullave të saj për shpërblimin;
5. metodikat dhe përshkrimet e modeleve, supozimet kyçe të vlerësimeve të rrezikut, si hipotezat matematikore ose korrelative të përdorura në veprimtaritë e saj të vlerësimin të rrezikut të kreditit, si dhe ndryshimet me rëndësi që u janë bërë;
6. çdo ndryshim të rëndësishëm në sistemet, burimet ose procedurat e saj dhe
7. nëse disponon, kodin e saj të sjelljes.

II. Dhënia periodike e informacionit

Agjencia e vlerësimin të rrezikut të kreditit jep periodikisht informacionin në vijim:

1. çdo gjashtë muaj, të dhëna rreth normave historike të mospërmbushjes të kategorive të saj të vlerësimin të rrezikut, duke bërë dallimin midis zonave kryesore gjeografike të emetuesve dhe nëse normat e mospërmbushjes në këto kategori kanë ndryshuar me kalimin e kohës;
2. çdo vit, informacionin e mëposhtëm:
 - (a) listën e 20 klientëve më të mëdhenj të agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit sipas të ardhurave të përfuara prej tyre dhe
 - (b) listën e atyre klientëve të agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit kontributi i të cilëve për normën e rritjes së të ardhurave të përfuara të agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit në vitin ushtrimor paraardhës e ka tejkaluar normën e rritjes në të ardhurat e përgjithshme të agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit gjatë atij viti me një faktor prej më shumë 1,5 herësh. Secili prej këtyre klientëve do të përfshihet në listë vetëm nëse, për atë vit, përbën më shumë sesa 0,25 % të të ardhurave të përgjithshme botërore të agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit në nivel global.

Për qëllimin e kësaj pike, 'klienti' është subjekti, shoqëritë e tij të kontrolluara dhe subjektet e lidhura në të cilat subjekti ka pjesëmarrje më të madhe se 20 %, si dhe çdo subjekt tjetër në lidhje me të cilin ka negociuar strukturimin e një titulli borxhi për llogari të një klienti dhe kur tarifa i është paguar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, agjencisë së vlerësimin të rrezikut të kreditit për vlerësimin e këtij titulli borxhi.

III. Raporti i transparencës

Agjencia e vlerësimit të rrezikut të kreditit vë në dispozicion çdo vit informacionin në vijim:

1. të dhëna të hollësishme mbi strukturën ligjore dhe pronësinë e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit, përfshi informacion mbi pjesëmarrjet;
2. një përshkrim të mekanizmave të brendshëm të kontrollit, që sigurojnë cilësinë e veprimtarive të saj të vlerësimit të rrezikut të kreditit;
3. statistikat mbi caktimin e personelit të saj për vlerësimet e reja të rrezikut të kreditit, rishikimet e vlerësimit të rrezikut të kreditit, metodikën ose vlerësimin e modelit dhe funksionarët kryesorë;
4. një përshkrim të rregullores së saj për mbajtjen e të dhënave;
5. rezultatin e rishikimit të brendshëm vjetor të funksionit të saj të pavarur të përputhshmërisë (*compliance*);
6. një përshkrim të rregullores së saj të menaxhimit dhe të qarkullimit të analistëvevlerësues;
7. informacion financiar mbi të ardhurat e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit të ndara sipas tarifave të veprimtarive të vlerësimit të rrezikut dhe atyre që nuk kanë të bëjnë me vlerësimin e kreditit, duke përfshirë një përshkrim gjithëpërfshirës për secilën prej tyre dhe
8. një deklaratë e drejtimit të brendshëm.